REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr.2694/6 Prot.

Patos, më 22/09/2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 21 SHTATOR 2026

Temë: "Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2027"

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak Patos

Ora: 10:00

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", VKB nr. 83, datë 17.12.2025 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027", si dhe njoftimit me nr. 2694/3 prot., datë 20.08.2026 me lëndë dëgjesë publike "Konsultim i ndryshimeve të paketës fiskale 2027"

Pjesëmarrës: ZV/ Kryetar i bashkisë Patos, znj. Ina Sauli, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme znj. Juela Shpata, Drejtor i Financave, znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj.

29 Pjesëmarrës prej të cilëve:

- Banorë;
- Kryetarë të fshatrave;
- Përfaqësues nga bashkia Patos;
- Përfaqësues nga grupe të ndryshme interesi.

Takimin hapet nga Sekretar i Këshillit Bashkiak, znj. Refaela Xeba- Të nderuar të



Sekretar i Këshillit Bashkiak
znj. Refaela Xeba

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2027

pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Qëllimi i kësaj dëgjese është informimi mbi nsryshimet e paketës fiskale 2027. Ju ftoj të dëgjojmë prezantimin nga ana e ekzekutivit dhe më pas presim pyetjet tuaja lidhur mbi këtë temë.

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj– Përshëndetje të gjithëve! Të nderuar grupe të interesit të biznesit, të nderuar përfaqësues të bizneseve, të pleqësisë së fshatrave! Sot si detyrë e ligjit të pushtetit vendor për hartimin e paketës fiskale për vitin 2027 jemi në



Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
z. Çajup Refitaj

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2027

dëgjesë publike lidhur me taksat dhe tarifat vendore për vitin 2027. Sipas strukturës së ndërtimit të paketës fiskale unë do të filloja me taksat. Kemi pjesën e taksave të ndërtesës, taksën e truallit, taksën e fjetjes në hotel dhe taksa të tjera të cilat paraprakisht po ju bëjmë me dije se nga ana jonë, nuk do të ketë asnjë ndryshim lidhur me këto taksa. E vetmja mundësi që mud të ndryshojë, sepse kemi qenë në pritje të këshillit të ministrave për vlerën e sipërfaqes për metër katror në bashkinë e Patosit. Ende nuk kemi një VKM që konfirmon këtë gjë. Pavarësisht se kemi qenë në pritje pasi Ministria e linjës përkatëse ka bërë një ndryshim, por ky ndryshim lidhet me referenca të tjera që i referohet pjesa e entit kombëtar të banesave për përllogaritjen e vlerave të banesave për privatizim apo nevoja të tjera. Po punojmë ende me VKM të 2023 që është rifreskimi i fundit i saj. Taksa për ndërtesën në bashkinë e Patosit është 28 mijë l/m^2 Mbi këtë në përllogarisim sipërfaqet e ndërtesave sipas taksa paguesve ku këtu ne kemi biznes dhe familjar, në grupimet që ne bëjmë. Pasi ojf janë të përjashtuara mbi bazën e përcaktimeve ligjore, gjithsesi e marrim në mesatarizim pasi te pjesa e biznesit ne e mbështesim këtë mbi bazën e veprimtarisë që ata kryejnë, ose objektin që ka secili prej bizneseve. Mbi këtë bazë ne bëjmë dhe kategorizimin e tyre. Lidhur me pjesën e individëve mënyra e përllogaritjes është e tillë që klasifikohen ndërtesat si grupe që i referohen privatizimit të ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992, ku niveli i taksës nga 100% shkon 70%, por dua të theksoj që të jemi të qartë, pjesa e ndërtesave që i referohet janë të ndërtuara para vitit '93, por ideja është që për lëto objekte që nuk janë vlerësuar nuk ka patur ndërhyrje në këto objekte. Nëse ka patur rivlerësime të këtyre objekteve jemi interesuar për vlerën e tregut të tyre dhe përsëri këto objekte tarifohen me të njëjtën formul sikurse përllogariten edhe ndërtesat pas vitit '93. Mënyra e përllogaritjes nqse do të futëshim me detajim është për

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

ndërtesat që shfrytëzohen për qëllime banimi, pra këtu kërkoj vemendje nga pjesa e taksapaguesve qytetarë. Në pjesën sot e taksojmë 15.4 l/m^2, për njësitë administrative, ndërsa për ndërtesat që shfrytëzohen për veprimtari ekonomike ne e taksojmë me 109.2 l/m^2 në qytetin e Patosit për biznesin dhe 92.4 l/m2 në njësitë administrative. Janë dhe veprimtaritë e tjera ku grupohen aktivitetet industriale me karakter prodhimi, përpunimi, magazinimi të lëndëve të para, produkteve të para në fabrika, magazina, depo, produkte ushqimore si dhe objekte të tjera të ngjashme. Ky grupim ka një vlerë 36.4 l/m2 për Patosin dhe 30.8 l/m2 në njësitë përbërëse të bashkisë Patosit. Janë edhe grupime të tjera që janë ndërtesat për veprimtari arsimore, publike, aktivitete sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura, në 36.4 l/m2 në qytetin e Patoait dhe 30.8 l/m2 në njësitë përbërëse të bashkisë Patosit. Bodrumet, parkimet e mbuluara, ndërtime me konstruksione druri dhe metalike 50.96 l/m2 në qytetin e Patosit dhe 43.12 l/m2 në njësitë administrative. Veprimtaritë në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe veprimtaritë mbështetëse, magazinimit, ruajtjes së produkteve bujqësore, blegtorale me përjashtim të përpunimit ushqimor kemi 21.84 l/m2 për qytetin e Patosit dhe 18.28 l/m2 për njësitë administrative. Grupimi i fundit janë ato njësi ekonomike të cilat sipërfaqet ndërtimore janë të pajisura me leje ndërtimi dhe nuk kanë arritur ta përfundojnë atë sipas afatit të përcaktuar në miratimin e kërkesës së lejes së ndërtimit. Pra bëhet fjalë për njësi të cilat kanë një ndërtim të këtij karakteri. 21.84 l/m2 është Patosi dhe 18.48 l/m2 njësitë administrative. Kjo ishte për pjesën e taksave për dy grupimet e taksa paguesve individ dhe biznes. Për pjesën e tokës bujqësore, taksa përcaktohet në ligj me kategorizimin e saj ku kategoria e I është 5600 l/ha, kategoria e dytë është 4900 l/ha, kategoria III është 4200 l/ha në vit, kategoria e IV është 3600 l/ha në vit, e V 3000 l/ha në vit, e VI 2400 l/ha, VII 1800 l/ha në vit. Kategorizimin e sipërfaqeve të tokave tani është i përfunduar. Pushteti vendor bashkëpunon me institucione të tjera, kryesisht me Këshillin e qarkut dhe bën kategorizimin e tokave. Duke qenë se pjesëmarrja sot është nga të tre njësitë administrative ju bëjmë me dije se ky kategorizim ka përfunduar dhe kemi një sistem të konsoliduar të përllogaritjes së këtyre sipërfaqeve për taksimin e tyre vjetor. Taksa e truallit për qëllime banimi e taksojmë në 0.14 l/m2 dhe 0.15 l/m2 për qëllime biznesi. Përllogaritjet janë bërë fikse për secilën. Këtu nuk kemi ndarje sipas njësive adminsitrative, por është në rang bashkie. Tarifat e pastrimit të biznesit vitin e kaluar pati një rritje në raport me paketën e vitin 2025. Për këtë në konsultim të vazhdueshëm edhe me pjesën e biznesit, sepse ne e kemi marrëdhënien me biznesin të përditshme, kemi kuptuar që ka një ndjeshmëri sepse vitin e kaluar rritja ishte nga 4 mijë lekë në 6 mijë lekë, por po shikojmë të gjitha mundësitë dhe alternativat sepse vjet në dëgjesë e kam theksuar se për shkak të kostove në investime

kapitale dhe infrastruktur, po ashtu edhe në pjesën e shpenzimeve operative dhe nga përllogaritja që kemi bërë mbi bazën e rezultateve të 2024 gjykuam të kishim rritjen sic e tham dhe pak më sipër. Gjithsesi në kushtet që po shqyrtojmë alternativa të tjera për uljen e kostos jemi duke studiuar faktin që këto tarifa ti shikojmë në një përmirësim në uljen e tyre. Gjithsesi jemi duke punuar në vazhdimësi për të parë se ku dhe si do jemi në raport me to sepse ka pasur edhe element të tjerë që kanë ndikuar negativisht në fakt te pjesa e kostive operacionale sic ka qenë ajo pjesa e karburantit që në fakt ka filluar po themi ka kohë që ka taksa goxha të larta. Kjo është pjesa e tarifës së pastrimit të biznesit. Nivelet janë po ato të fundit dhe do ngelen ato cfarë janë në paketën e 2026. Këtu kemi një grupim që kemi bërë te biznesi duke kategorizuar atë sipas madhësisë ku kemi grupimin e parë që është biznesi i vogël që ne e quajmë që ka një xhiro deri në 5 mln lekë. Ndërsa biznesi i mesëm është në kufi 8 mln dhe i madhi mbi 8 mln lekë. Këtu kemi të grupuara dhe është një list goxha e gjatë sipas natyrave të aktivitetit. Në raport me natyrat e tjera kishim një ngarkesë më të lartë për prodhimin e mbetjeve në raport me bizneset e tjera dhe kemi shtuar edhe disa kategori të tjera. Por megjithatë biznesi i vogël për ato njësi prodhimi që tregtojnë mish, peshk, fruta perime dhe ushqime, vlera e tarifës së pastrimit është 11 mijë lekë në qytetin e Patosit dhe 8 mijë lekë në njësitë administrative. Aktivitetet që kanë objekt tregtimin e artikujve industrial, veshje etj të ngjashme me to janë po në këto nivele. Restorantet, bare, piceri, fast food dhe biznese trë ngjashme me to kanë po të njëjtin nivel tarife. Ky nivel tarifimi shkon deri te grupet që janë klinika të specializuara sic janë klinikat dentare. Tarifat për këto shkojnë 12 mijë lekë për qytetin e Patosit dhe 9 mijë lekë për njësitë administrative. Grupi i sipërmarrjeve të mëdha si SHA dhe SHPK që kanë shërbime me nergji elektrike, telefoni, post dhe ujësjellës, kjo tarifë shkon 120 mijë lekë, për institucionet shtetërore shkon 100 mijë lekë, shërbimet spitalore 170 mijë lekë, banka, filiale bankash, kompani telekomunikacioni shkon 120 mijë lekë, agjencitë financiare dhe filialet e tyre 40 mijë lekë, televizorët privat ose radio 30 mijë lekë, shoqatat jofitmprurëse ose donancionet 15 mijë lekë, ambulantët 6 mijë lekë. Janë dhe njësitë e prodhimit që shtrihen nga 11 mijë në 29 mijë lekë. Janë prodhime që konstestojnë në veshjet e sallave dhe organizimin e eventeve nga 11 mijë deri në 150 mijë lekë te binesi i madh. Përpunim metali, druri, letre, plastmas, duralumini, karbon etj nga 11 deri në 55 mijë lekë. Për të vazhduar me materiale të tjera ndërtimi si tulla, tjegulla, cimento, furra etj në 80 mijë lekë. Kemi dhe pjesën e tarifimit për tarifën e pastrimit për kantjerët që janë me leje ndërtimi. Këtu kemi të bëjmë me një grupim sipas vlerës së preventivit në investim ku jemi në vlera nga 1 mln lekë deri në 500 mln lekë. 7 mijë lekë është tarifa e pastrimit në minimum dhe maksimum është 550 mijë lekë. Për të kaluar te kompanitë e

nxjerrjes hidrokarbur, për kompaninë Albpetrol është parashikuar tarifa e pastrimit 3 mln e 500 mijë dhe për kompaninë Bankers po kaq. Për Terra oil Sëiss në 2 mln lekë. Këto ishin në përgjithësi pjesa e tarifave për të kaluar më pas dhe në pjesën e lehtësirave, vazhdojmë me të njëjtën kategori që përfitojnë lehtësira. Kemi pjesën e pensionistëve te individët ku pensionistët e vetmuar ta theksojmë përjashtohen nga taksat dhe tarifat, por për këtë përjashtim është përcaktuar dhe dokumentacionin ku duhet që pronësia të jetë mbi kryefamiljarin e pensionistëve të vetmuar. Dispozitat ligjore nuk ka ndryshim. Pjesa e tarifave të ndricimit kryesisht për bizneset i kemi në bashki vlera shkon në 2 mijë e 500 lekë në vit ndërsa për njësitë administrative shkon 2 mijë e 200 lekë në vit. Këto natyrisht janë të grupuara sipas bizneseve. Kjo i përket biznesit të vogël me aktivitet xhiro deri në 5 mln lekë. Pjesa e biznesit të mesëm me xhiro nga 5-8 mln lekë ka 4 mijë lekë tarifa dhe 3400 lekë për njësitë administrative. Ndërsa biznesi i madh e ka këtë tarifë 7 mijë lekë në qytetin e Patosit dhe 6 mijë lekë për njësitë administrative. Institucionet e kanë 25 mijë lekë, bizneset e kanë 150 mijë lekë, subjektet SHA dhe Shpk e kanë 25 mijë lekë. Për të kaluar të tarifa e ndricimit pjesa e lehtësirave është e njëjtë sikur e thash pak më sipër me grupimet që përfitojnë. Këtu mund të përmendim dhe faktin që kemi lehtësira për pjesën e emigrantëve që hapin biznese për 2027 tarifa e tyre do të jetë zero. Tarifat e fermerëve i kemi të përjashtuara nga tarifat. Tarifa e ndricimit është e ndërtuar sikurse dhe tarifa e pastrimit e grupuar në nivele për pjesën e biznesit, ndërsa te pjesa e individëve familjar ndricimi dhe gjelbërimi futen te tarifa e shërbimit komunitar sic e shikojmë pak më posht për secilën kategori dhe njësi të dhëna në vlera. Biznesi trajtohet me të njëjtën formul ashtu sikurse ishte tarifa e ndricimit. Te pjesa e tarifës së pastrimit për individët. Pjesa e tarifës së pastrimit për individët me një qëndrueshmëri moslëvizëse të themi, kategorizimi është ëbrë mbi bazën e familjes, ku është parë që familjet 1-2 persona të jenë 1200 l/vit, 2-3 persona 1400 l/vit për pjesën e Patosit dhe Zharrëzës, pasi këto dy njësi nuk kanë ndryshime nga njëra tjetra, si në infrastrukturë dhe ndricim. Për të kaluar me njësinë Ruzhdie, ku fshatrat të cilat do të tarifohen me tarifa janë fshati Ruzhdie dhe Gjynoqarë për 300 lekë/ Vit për familje .

Tarifa e shërbimit komunitar për qytetin e Patosit dhe Zharrëzes do të jetë 7-00 l për dy njësitë. Fshatrat Drenie, Kasnixë dhe Siqecë deri në përfundim të infrastrukturës nuk do të tarifohen me tarifën e shërbimit komiunitar, gjelbërimit dhe ndricimit. Në mënyrë të përmbledhur ky ishte dhe propozimi ynë për vitn pasardhës për vitin 2027. Jemi ta hapur për pyetje dhe sugjerime. Faleminderit!

Kryetar i fshatit Siqecë, z. Myftar Sorraj- Përshëndetje! Bdoqa me vëmednje taksimin e



Kryetar i fshatit Siqecë
z. Myftar Sorraj

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës

Fiskale 2027

banesave të vjetra. Aty pash një shënim për ne që kemi banesat tonë në Siqec të ndërtuara para viteve '50, sikur nuk shkon kjo. Pastaj ishin dhe banesat pa rikonstruksion 14,9 lekë. Së dyti për sa i përket taksimit të tokave bujqësore, i ndoqa me vemendje kategoritë. Tani ky boniteti i tokës, kur është marrë ky për kategorinë. Flas për Siqecën nuk ka kategori Siqeca të parë, të dytë. Jemi toka dielli pa ujë. Tani ku jeni bazuar që keni nxjerr këtë cmim të tokave. Ne jemi toka mbi ujë dihet botërisht. Kisha tjetër për sa i përket pensionistëve të vetmuar. Nga cilat taksime këta pensionistë përjashtohen? Sot ne jemi pa azhornim, pa pronësi, kush e mban përgjegjësinë? Nuk kemi certifikatë pronësie?

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Cajup Refitaj–. Për pjesën e pensionistëve e theksova që



Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
z. Cajup Refitaj

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës


Fiskale 2027

përjashtohen si nga taksat dhe nga tarifat, por taksë ndërtese, taksë trualli, pastrimi dhe shërbimi komunitar, por e theksova me kushtin që banesa të jetë në pronësi të pensionistit kryefamiljar. Sepse ai mund të rrij te ajo banesë që mund ta ketë në emrin e vajzës ose të djalit. Pjesa e certifikimit del jashtë kompetencave që kemi si pushtet vendor. Në këto kushte ne kemi qënë të detyruar të vendosim faturimit afrofe. Ne kemi pjesën e ndërtesave të ndërtuara para viteve 1991 me formularin 01. Këto janë të identifikuara si objekte. Grupi tjetër mendoj që në 90% të rasteve të gjitha objektet që janë ndëruara para vitit '90 ne kemi marrëdhënie me ASHK ku marrim informacion për të gjithë ata individ që kanë aplikuar për legalizimin e këtyre objekteve. Por deri në certifikimin e pronës ku kemi parë që praktikat ndryshojnë dhe certifikimi bëhet në emrin e fëmijës ose në emrin e një anëtari tjetër të

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

familjes, prandaj dhe pjesën e ndërtesave që janë në proces legalizimi, ne nuk i kemi konsideruar deri në momentin që ato certifikohen. Kështu ëë deri në këto momente kështu kemi vepruar sepse duhet të qartësojmë kush është pronari.

Kryetar i fshatit Siqec, z. Myftar Sorraj- Aktualisht prindërit e mi kanë ndërruar jetë. Certifikatë nuk kanë lënë. Tani unë jam atje kryefamiljar i kësaj banese, si do të përfitoj unë? A është bërë boniteti i tokës?



Kryetar i fshatit Siqec
z. Myftar Sorraj

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës

Fiskale 2027

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj- Në dijenin time personale ka dal ligji 22/ 2020 po themi për certifikimin e pronave para viteve '90 dhe ka një praktikë që kryefamiljari që ka formularin 01 bën aplikimin në ASHK. Në rastin tuaj, unë praktikën si mund të vazhdohet nuk e di sepse është pjesë e një institucioni të specializuar sic është ASHK që të të jap një orientim lidhur me mënyrën se si duhet vepruar. Kurse pjesa e taksës së tokës lidhur me njësinë tuaj nuk ka kategorizime lidhur me grupin e I dhe II. Boniteti i një sipërfaqeje toke nuk mbështet te pjesa që është një sipërfaqe kjo që nuk ka ujë etj. Boniteti konsiston në element të tjerë që kanë të bëjnë me prodhimtarinë e saj, po themi elementet përbërës. Ka raportin mbi prodhueshmërinë sepsë një sipërfaqe toke te ju dhe një sipërfaqe toke në Zharrëz nuk ka të njëjtin prodhim. Prandaj dhe kategorizimi është ërë i tillë. Dhe nuk ka kategori të grupit të I dhe II që kategorizohen në njësinë tuaj administrative. Lidhur me bonitetin e tokës është i bërë. Azhornimi dhe kategorizimi nuk janë njëlloj. Azhornimi është i lidhur qartë me pjesën e sipërfaqeve që të ndahen qartë kufijt. Nuk ka lidhje me kategorinë e tokës. Ajo lidhet me produktivitetin e saj. Specialistët nga bujqësia kanë përcaktuar kategoritë. Objektet para '90 e cilësova dhe e thash, por në vijim të fjalës theksova dhe faktin rivlerësimin e objekteve. Vet shteti nxjerr rivlerësim të banesave dhe jo më kot ju thash VKM që kanë nxjerr vlerën e një sipërfaqe banimi në Patos rivlerësimi në kuptimin e ligjit dhe taksimit është pjesa që ne e marrim për bazë.



Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
z. Cajup Refitaj

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës

Fiskale 2027

Kryetar i fshatit të Ri, z. Bexhet Rredhi- kategoritë e tokave në fshatin e Ri dihet që janë toka të nivelit të lartë. Si paguhen taksat? Paguhen tamam me kushtet që kanë dhe të gjitha? Taksa e ndricimit si paguhet në bazë të harxhimit apo është thjesht fikse sepse kemi dhe shumë llamba të djegura. Pjesa e kategorisë së parë si paguhet ajo? Me të gjitha kushtet apo jo?



Kryetar i fshatit të Ri
z. Bexhet Rredhi

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës

Fiskale 2027

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj- Njësia administrative Zharrëz ka një sipërfaqe të vogël që është kategoria e I pastaj të gjitha shkojnë kategoria II dhe III, IV. Në vijim të pyetjes që kishte dhe zotëria nga njësia Ruzhdie, nuk përfshihet te pjesa e përllogaritjes së tokës sepse po të shikoni në paketë fiskale kemi tarifa të vecanta për ujitje dhe vaditje, kështu që kjo është mbi bazën e prodhimtarisë së këtyre sipërfaqeve. Nga një moment që ka qenë një sipërfaqe e caktuar për njësinë Zharrëz që ishin në ujë, është punuar akoma për të futur dhe sipërfaqe të tjera në sistemin e vaditjes, por kategorizimi nuk ndryshon për faktin se këto toka janë në ujë. Nuk ndikon vaditja e tokave në taksa. Pjesa e tarifës së ndricimit ka dicka sepse nuk merret ne konsideratë vetëm harxhimi. Sepse janë edhe elementët e mirëmbajtjes sepse përfshihet ndërrimi i llambave sepse ato digjen, punimin e sipërfaqeve të shtruara me ndricim dhe element të tjera që merren gjatë punimeve që kryhen. Tarifa e ndricimit nuk konsiston vetem te harxhimi i energjise elektrike.


ZV/ Kryetar, znj. Ina Sauli- A keni raportuar dikë për llambat e djegura? A është përcjellë njoftimi?



ZV/ Kryetar
znj. Ina Sauli

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2027

Kryetar i fshatit Zharrëz, z. Abedin Hoxha- janë raportuar por nuk kanë ardhur ti ndërrojnë akoma. Në zharrëz kemi ndenjur 9 muaj pa drita. Taksat i kërkoni ju, por dritat nuk janë vendosur.



Kryetar i fshatit Zharrëz
z. Abedin Hoxha

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2027

Përgjegjës i ASHP, z. Ardit Ngjeliu-Për pjesën e ndricimit do të rregullohen të gjitha dhe brenda muajit tetor në njësinë Zharrëz nuk do të ketë asnjë dritë të pa ndërruar dhe pa ndezur.



Përgjegjës i ASHP
z. Ardit Ngjeliu

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2027

Kryetar i fshatit Rerës, z. Shaban Rucaj- Ne kemi një problem sepse nuk kemi azhormin të



Kryetar i fshatit Rerës
z. Shaban Rucaj

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2027

tokave. Ky është një problem i madh në shumë fshatra të Patosit sepse vjen taksa vjetore dhe njerëzit futen në lëvizje të paguajnë. Më kanë kapur shumë njerëz dhe jemi në konflikte shumë të mëdhaja. Sepse është një pronë e padokumentuar, dhe ne po hasim shumë probleme sepse nuk kemi dokumente dhe na pyesin ku i ke dokumentat. Ky azhornimi që po flas, do bëhet apo nuk do kaloj? Qytetari mund të jetoj jashte dhe të kërkoj tokën e tij këtu dhe se di ku e ka. Unë kam shumë probleme, me tokat etj dhe nuk marrim dot zgjidhje do vij policia, do vij kjo, ajo. Tani këto kanë shumë veta të përfshirë. Jemi shtet dhe situatat duhet të marrin një rrugë. Dua të bëhet të sistemohen pronat në këtë drejtim.

Zv/ Kryetar, znj. Ina Sauli- Lidhur me këtë ceshtje është ngritur ky problem në disa



Zv/ Kryetar
znj. Ina Sauli

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2027

dëgjesa, por roli i bashkisë në këtë proces është mbështetës, por asnjëherë nuk është vendimmarrës për procesin e azhornimi të tokave. Maksimumi do të jetë në një proces mbështetës për evidentimin e tokave, por asnjëherë nuk jemi dot ne që ta nisin dhe përfundojmë si proces. Është komplet jashtë kompetencave tona.

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj- unë nuk kam cfarë shtoj më shumë, por dua të them që ne veprojmë mbi bazën e dokumentave dhe për tokat marrim parasysh Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi dhe formularin 6. Këto janë problematika që vijnë për shkak të azhornimit. Këto janë problematika që vijnë si pasojë e rezultateve njerëzore pasi ka nga ata që shkojnë zënë rrugën. Kemi pasur shumë raste dhe me policinë. Kjo në njëfarë mënyrë është dhe pjesë e kompetencave tona dhe nuk ka dal jashtë vëmendjes tonë. Nuk besoj se

është azhornimi ai që ndan pjesën e këtyre konflikteve. Ne taksapaguesit i taksojmë mbi këto dokumenta.

Kryetar i fshatit Verbas, z. Bilbil Çepele- Përshëndetje! A përjashtohen nga tarifa për



Kryetar i fshatit Verbas
z. Bilbil Çepele

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2027

ndricim ata që nuk kanë ndricim? Ndricimi është lë për të dëshiruar në xhaden kryesore dhe te pjesa e fundit nuk ka ndricim. Kanë vën një lloj panelesh diellore që nuk kanë ndriçim, po të kalosh ndizen ato. Nuk ndricojnë fare ato dhe sensori është fallco.

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj- Për të sqaruar pjesën e tarifave të ndricimit e gjithë nnjësia Zharrëz në pjesën më të madhe të saj është e ndricuar dhe ne aplikojmë tarifë ndricimi sepse tarifa nuk synon vetëm harxhimin, por edhe perspektivën e investimit. Për pjesën teknike të funksionimit të ndricimit përfitojmë nga rasti se kemi Arditin këtu si specialist të fushës që mund të japi një shpjegim.



Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
z. Çajup Refitaj

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2027

Përgjegjes i ASHP, z. Ardit Ngjeliu- Ato janë drita shumë të mira, janë ndricim me energji që janë shumë herë më të mira. Të gjitha njëlloj nuk i bëjmë dot, por ato janë shumë të mira.



Përgjegjes i ASHP
z. Ardit Ngjeliu

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të
Paketës Fiskale 2027

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

Banore e lagjes Naftëtari, znj. Qazime Metushi- Jam një qytetare e Patosit. Kam marr një



Banore e lagjes Naftëtari
znj. Qazime Metushi

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2027

tokë me ligjin 7501, e ka marr djali dhe djali po bën 25 vjet që ka ikur në Itali. Është nënshtetas italian. Tokën e paguajmë për cdo vit. Për sivjet i ka ardhur dhe një fatur të pastrm gjelbërimit që ai taksat i paguan atje ku banon. A është e drejtë kjo që ai të paguaj taksën kur ai nuk ka as shtëpi që të paguaj taksë, dhe për të ardhur me pushime vjen te prindërit. Atëherë pse vjen kjo tarif gjelbërimi?

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj- Ky është i disajti vit i dëgjesave që ne kemi të tilla pyetje për pjesën e emigrantëve. Cdo familje që është rezidente brenda territorit të bashkisë Patosit ne e tarifojmë. Në rast se ka ndërtesë e taksojmë dhe për ndërtesën. Pjesa e tarifës është e drejtë që të ngrihet, por gjithsesi ne nuk mundet që të verifikojmë se sa ditë qendron në territorin e bashkisë Patos dhe sa qendron atje ku ka vepimtarinë apo familjen e tij etj. Ne nuk kemi mundësi të verifikojmë, e vetmja mundësi verifikimi është një sistem që përdor policia e shtetit, por ne nuk kemi akses të futemi dhe të ndjekim ditët e qendrimit. Në këto kushte e kemi të pamundur ti etiketojmë. Sepse ka dhe nga ata emigrantë që kanë dhe objekte në bashkinë Patos. Por kur vijnë këtë ndërtesë e gjejnë të pastruar, ndricuar e të gjitha më radhë. Sepse ky është një kontribut që ne e japim dhe ai objekt ka vlerën e vet dhe ka kontributin e vet. Për sa kohë ai është i pastër i mirëmbajtur si objekt dhe sa kohë do kenë gjendjen civile në Patos ne do e kemi të pamundur që ti përjashtojmë. Duke qenë se ne nuk i identifikojmë dot barra na bie te taksapaguesit e tjerë dhe nuk ka pse një taksapagues tjetër të paguaj për një që ka kategorinë emigrant, por këto lloj shërbimesh i shfrytëzon për një muaj, dy apo tre dhe në këto kushte ne e kemi të pamundur ti identifikojmë. Unë mbështetem në ligj, nuk mund të mbështetem në komunikimet private. Djali juaj nuk ka banesë dhe ne nuk të kemi taksuar, por tarifat vendore i mbështesim mbi bazën e gjendjes civile e rezidencës shqiptare.

Banore e lagjes Naftëtari, znj. Qazime Metushi- Falemінderit për sqarim por ky emigrant po në 2 vite jashtë shtetit dhe nuk ka asnjë gjë këtu. Edhe tokën ja kanë dhuruar dhe taksat e

asaj toke i kam paguar vit për vit. Sivjet janë vendosur tarifa të tjera. Si më takson mua shtetit taksa të tjera. Unë këtë të drejtë do ta kërkoj dhe më tutje. Më gjej mua në sistem ku jeton ky person, ku ha, ku pi dhe më kërkon ti mua taksën këtu. Ca pastrimi ka ai për të paguar, ai nuk jeton këtu?



Banore e lagjes Naftëtari
znj. Qazime Metushi

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të
Paketës Fiskale 2027

Zv/ Kryetar i bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- kjo është e miratuar me vendim të këshillit të



Zv/ Kryetar i bashkisë Patos
znj. Ina Sauli

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të
Paketës Fiskale 2027

ministrave dhe ne nuk mund ta personalizojmë. Përjashtimet janë për ato kategori që janë të parashikuara në paketë fiskale.

Përfaqësues nga Albpetrol, z. Dritan Shahu- do të donim një sqarim në lidhje me tarifën e ndotjes së mjedisit, truallit, ndërtesës, pastrimit dhe ndricimit sa janë këto vlera? Ka ndonjë ndryshim nga paketat e mëparshme dhe si kanë ndryshuar këto?



Përfaqësues nga Albpetrol
z. Dritan Shahu

Dëgjesë publike me temë:
Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2027

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj- ndryshime nuk ka në raport me vitin e kaluar. Taksa e truallit sikurse e thash dhe në relacion është e njëjtë për të gjitha subjektet dhe është 15 l/m2. Ajo që keni në më shumë se 80% ose më shumë ndërsa pjesa e tarifës së pastrimit e thash që e keni 3 mln e 500 mijë, ndërsa ndricimi ishte 150 mijë, nuk ka ndryshim nga paketa e vitit të kaluar. Në lidhje me ndotjen mjedisore as ajo nuk do ketë ndryshim dhe do jetë në të njëjtat nivele si në vitin e kaluar.

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba